

**STATUT**  
**I**  
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“SUNITY COMPANY” SHPK**

**KREU I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Selia**

**Neni 1: Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Sot më datë 29.04.2020, në mbështetje të legjislacionit shqiptar respektivisht Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare“ dhe Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, ne Ortaket e Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **“SUNITY COMPANY” Shpk**, formulojmë Statutin e saj, si me poshte vijon,

Ortaket e shoqërisë jane:

1. **NIKOLLA LAÇI**, i datëlindjes 25.08.1939, lindur ne Durres, madhor dhe me zotesi te plete per te vepruar, me numër identifikimi D90825054V

**Neni 2: Objekti**

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë si më poshtë:

- Aktivitet ne fushen e hotelerise dhe turizmit. Tregtim te artikujve e pajisjeve te ndryshme qe perdoren ne sektorin e hotelerise, bar, restoranteve, etj.
- Aktivitet ne fushen e sherbimit social, restoran, bar-kafe, piceri, etj
- Menaxhim lavanderie industriale, marrje me qira, larje te mbulesave e carcafeve, peshqireve per hotele, restorante, spitale dhe ente te ndryshme.
- Aktivitet ne fushen e projektimit dhe ndertimit te te gjitha llojeve si banesa

civile, ndertime industriale dhe tregetare, komplekse turistike, autostrada, kanalizime, vepra hidroenergjite.

- Tregtim te artikujve te ndryshem industriale, artikuj shtepiake e produkte te konsumit te gjere, artikuj kozmetike, mobilieri e pajisje zyrash, pajisje hotelesh, restorantesh, pajisje makineri, konfeksione, pajisje elektrike e elektronike, elektroshtepiake, hidrosanitare, etj.
- Shoqeria ka per objekt çdo lloj sherbimi ne fushat e manaxhimit, te blerjes, shitjes dhe qiradhenies se pasurise se patundshme, te ndermjetesimit imobiliar, financimit dhe te drejtes se pasurise se patundshme si dhe çdo lloj veprimi ne lidhje me pasurite e te patundshme .
- Transport kombetar dhe nderkombetar mallrash te ndryshme dhe udhetaresh per vete dhe per te trete.
- Shoqeria sipas nevojave te aktivitetit ka te drejten e ushtrimit te çdo aktiviteti te ligjshem, te lejueshem per formen e shoqerise, e cila nuk ndalohet me ligj(sipas nenit 7 te Ligjit nr.9901,dt.14.04-08).

### **Neni 3: Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

### **Neni 4: Selia**

Selia e shoqërisë do të jetë:

**Lagja 3, Rruga Egnatia, Pallati Fly Tower, Kati 10 , Durrës.**

Shoqeria mund te hape filiale, dege apo perfaqesi ne te gjithe territorin shqiptar dhe jashte vendit.

**Kreu II**

**Kapitali i regjistruar**

### **Neni 5: Vlera dhe pagesat e kapitalit të regjistruar**

Kapitali i shoqërisë është **10.000(dhjetemijemije)** Lekë, i ndarë në 1 kuota.

Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

**NIKOLLA LAÇI** është zotëruar i 1 kuote, me 100 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë, ne vleren 10.000 leke.

#### **Neni 6: Pagesa e kuotave**

Administratorët mund t'i kërkojnë ortakëve pagimin e kontributeve në para të pashlyera në lidhje me kuotat e tyre.

Në rast të mos shlyerjes së kontributeve, sipas përcaktimit të administratorit, personi përgjegjës do të paguajë një kamatë vonesë mbi shumën e papaguar me interes prej 4% në vit.

#### **Neni 7: Kalimi i kuotave**

Kalimi i kuotave dhe i të drejtave që rrjedhin prej tyre, mund të bëhet me kontratë shitblerje, me dhurim, me trashëgimi ose me çdo mënyrë tjeter të parashikuar me ligj.

#### **Neni 8: Zmadhimi e zvogëlimi i kapitalit themeltar**

Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve.

Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicë të kualifikuar të votave.

### **Kreu III**

#### **Asambleja e përgjithshme**

#### **Neni 9: Të drejtat dhe detyrimet**

Asambjeja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë,
- b) ndryshimet e statutit,
- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve,
- d) emërimin dhe shkarkimin e likujdatorëve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar,
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë,
- f) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit,
- g) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre,
- h) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve,
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë,
- j) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë,
- k) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

#### **Neni 10: Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme**

- a) Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori të paktën 2 herë në vit, për të miratuar përkatesisht bilancin vjetor të mbyllur dhe bilancin vjetor parashikues.
- b) Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nëpërmjet një shkrese dërguar çdo ortaku me postë të zakonshme ose mesazh elektronik. Njoftimi duhet të kryhet të paktën 7 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen.
- c) Ortakët, që zotërojnë të paktën 5% të kapitalit të regjistruar kanë të drejtë të thërrasin mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet administratorit ose edhe pa ndërmjetësimin e tij.

#### **Neni 11: Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme**

- a) Mbledhja e Asamblesë është e vlefshme nëse në të marrin pjesë ortakë që zotërojnë më shumë se 30% të aksioneve, për të vendosur për çështje të zakonshme. Në këtë rast vendimi i Asamblesë është i vlefshëm nëse është

votuar nga shumica e votave të ortakëve pjesmarrës, (e cilësuar në këtë statut si “shumicë e thjeshtë”).

- b) Mbledhja e Asamblesë, për të vendosur për çështje të vecanta si: ndryshimi i statutit, zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit të regjistruar, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, është e vlefshme nëse në të marrin pjesë ortakë që zotërojnë më shumë se 50% të kuotave. Në këtë rast vendimi i Asamblesë është i vlefshëm nëse është votuar nga jo më pak se tre të katërtat e votave të ortakëve pjesmarrës, (e cilësuar në këtë statut si “shumicë e kualifikuar”).
- c) Mbledhja e Asamblesë drejtobhet nga administratori nëse është e thirrur prej tij. Nëse Asambleja e Përgjithshme është thirrur nga pakica, atëherë ajo kryesohet nga njëri nga ortakët e zgjedhur nga pjesëmarrësit në atë mbledhje.
- d) Administratori pavarësisht se nuk është ortak, ka të drejtën e pjesëmarres si edhe të marri fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme.

#### **Neni 12: Votat e Pjesëmarrësve**

- a) Çdo ortak ka te drejta vote ne perpjeshetim me vleren nominale te kuotes se tij.
- b) Asnjë ortak nuk voton në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet, që kanë të bëjnë me kuotat, që ai disponon.

#### **Neni 13: Emërimi i Administratorit**

- a) Administrimi si dhe perfaqesimi i shoqerise i besohen një ose me shume Administratoreve që mund edhe te mos jene ortake.
- b) Administratori emerohet per 5- vjet nga regjistrimi I shoqerise pranë QKR-së, me te drejte riperteritje, me perjashtim doreheqje apo shkarkimi nga ana Asamblese.
- c) Detyra e Administratorit I ngarkohet z. **NIKOLLA LACI**, te cilit i jepet e drejta e firmes dhe e perfaqesimit e shoqerise.
- d) Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë në çdo kohë Administratorin nga detyra, me shumicë të zakonshme votash, me kusht që në mbledhje të

marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave

#### **Neni 14: Kompetencat e Administratorit**

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet:

- a. të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme,
- b. të përfaqësojë shoqërinë,
- c. të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë,
- d. të bëjë të mundur përgatitjen nga specialisti i ngarkuar dhe të nënshkruajë bilancin vjetor parashikues për vitin e ardhshëm, për tu miratuar nga Asamblea e Përgjithshme, brenda dates 20 tetor të vitit paraardhës.
- e. të bëjë të mundur përgatitjen nga specialisti i ngarkuar dhe të nënshkruajë bilancin vjetor të myllur, për tu miratuar nga Asamblea e Përgjithshme, brenda dates 20 mars të vitit të ardhshëm dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim,
- f. të krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë,
- g. të kryejnë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë,
- h. të raportojë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare,
- i. të kryejë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe statut.

#### **Neni 15: Mbledhjet e Administratorit**

Administratori kujdeset që në libra të posaçëm të mbajë proces verbalet e të gjitha takimeve të kryera nga ai, si dhe të gjitha mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.

**Kreu VI**  
**Shpërndarja e fitimit vjetor të shoqërisë**

**Neni 16: Shpërndarja e fitimit vjetor**

- a) Pjesa e fitimit që i takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë, vendoset të shpërndahet nga asambleja e përgjithshme.
- b) Asambleja e Përgjithshme ka kompetencë t'u shpërndajë ortakëve pjesën e fitimit në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që kuotat e secilit ortak përfaqësojnë.
- c) Po ashtu, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë që një pjesë e fitimit vjetor të mos u shpërndahet ortakëve, por këto shuma të përdoren për zmadhimin e kapitalit filletar apo për qëllime të tjera, të cilat ajo i konsideron të dobishme për shoqërinë.

**Kreu VII**  
**Prishja dhe njoftimet**  
**Neni 17: Prishja dhe likuidimi**

- a) Në rast të likuidimit të shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme emëron një likuidator, i cili administron shoqërinë deri në mbylljen e procesit të likuidimit.
- b) Me vendimin e posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicë të kualifikuar, pasi janë shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditorëve të shoqërisë, likuidatori shpërndan pjesën e mbetur të pasurisë së shoqërisë ndërmjet ortakëve. Kjo shpërndarje e fundit bëhet në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që kuotat e secilit ortak përfaqësojnë.

**Neni 18: Ftesa për kreditorët**

Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Shoqëria e publikon dy herë këtë njoftim, me një interval prej 30 ditësh, në faqen e

saj të internetit, si dhe në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Në njoftim duhet dekluaruar se pretendimet duhet të depozitoohen brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të fundit.

#### **Neni 19: Përfundimi i likuidimit**

- a) Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë
- b) Veprimtaria e likuiduesit nuk mund të kundërshtohet pas çregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

#### **Neni 20: Dispozitat e fundit**

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me normat e këtij statuti.

Për çdo gjë tjeter, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKR-në si dhe çdo ligj tjeter mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

#### **Ortaket e Shoqerise**

**NIKOLLA LAÇI**

